REPUBLIKA E SHQIPERISE

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

Bordi i Komisionereve

***VENDIM***

***Nr. 75 Datë 12 .10.2009***

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SH.A PËR KONSUMATORËT TARIFORË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.80, datë 26.06.2008, "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes se tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a për përcaktimin e tarifës të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a për konsumatorët tariforë, për vitin 2010.

**Vendosi :**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë për vitin 2010.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.sh.a.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**
**BUJAR NEPRAVISHTA**

# REPUBLIKA E SHQIPERISE
## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve

**Votimi i Bordit të Komisonerëve të ERE-s për,**

***VENDIMIN***

***Nr. 75 Datë 12 .10.2009***

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SH.A PËR KONSUMATORËT TARIFORË**

**Anëtarët e Bordit**

| | Pro | Kundër |
|---|---|---|
| **Bujar Nepravishta** | ______________ | ______________ |
| **Entela Shehaj** | ______________ | ______________ |
| **Ardian Haçi** | ______________ | ______________ |
| **Abaz Aliko** | ______________ | ______________ |
| **Shkëlqim Bozgo** | ______________ | ______________ |

Adresa:Rruga "Gjergj Fishta"10
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
ëëë.ere.gov.al